

VËSHTRIM

Prindërit e mi, pjesëmarrës në seminar

Para marrëveshjeve të Brukselit, Kosova dhe Serbia kanë qenë të mbyllura hermetikisht, dy sisteme të ndryshme qeverisëse që ngajnë me shtete totalitare që mes vete kanë mure. Sot ka një komunikim të padukshëm, por të rëndësishëm

Autor: Idro Seferi

Ishte shumë i lumtur, kur në vitin 2010 prindërit e mi poudhëtonin me autobus drejt Beogradit, për të më vizituar. Ishte vizita e tyre e parë që po më bënin, pas shumë viteësh që jetonim në kryeqytetin e Serbisë. Mu lajmëruan kur e kaluan Merdaren, fshat ky, ku për Kosovën është vendosur kufiri, kururse për Serbinë një kallim administrativ. Ishte një mundim që edhe vetë e kisha kaluar disa herë.

Në përjekje për të ndihmuar njerin nga prindërit e mi për vizitë të mjekua në Beograd, i kisha ftuar të dy prindërit të vëllin këtu. Por për këtë më duhej një letër, miratim i ministrit ose i Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë për ta kaluar Merdaren.

Si bëhej kjo? - një ftesë zyrtare? Këtë ftesë e kisha siguruar nëpërmjet një mikeje të ndëruar nga një organizatë joqeveritare, e cila i lisiot emrat e prindërve të mi si pjesëmarrës nga Kosova në një aktivitet të saj. Kolegjeve dhe miqve të mi në dikom-bëtarë të kohën u vënin familjarë nga të gjitha vendet. Për qytetarët e Kosovës ishte gjithmonë problem të hyjnë në Serbi, apo të kalojnë përmes saj me dokumentet e Kosovës.

Prindërit kurrë nuk më kanë kundërshtuar për të jetuarit në Beograd, punarësisht se për këtë nuk janë pajtuar me zemër. Gjithmonë më thoshin që, në rast rreziku ose keqrcenimi, të fluturoj për në Podgoricë. Përveç vizitës mjekësore, për

mua ishte me rëndësi që prindërit e mi ta dinin se ku jetoja dhe se isha i sigurt. Për ata ishte thyerje e një miti të frikës së krijuar bazuar në përvaj të ekeqija dhe torturat që im ati kishte kaluar në vitet e 90-ta.

Kur arriam në Beograd, gjithëksha shkoi mirë. Në tramvaj, prindërit e mi flisnin gati pa zë dhe me shenja gishtash. 'Kur hyri policia në tramvaj, na i pa letrat që kemi ftesë për seminar për krime lufte', më tregonte nëna. Babai im edhe kishte harruar se në çfarë seminary po shkonte. Ishin dy pleq që po shkonin në seminar për tu trajtuar.

Nga koha kur Prishtina dhe Beogradit filluan me implementimin e marrëveshjeve të arritura në Bruksel, vizitat që më bëjnë prindërit nuk janë përvoja kaq dramatike. Tani ata mund të vijnë dhe të kalojnë kufirin normalisht dhe pa shumë frikë, anipse ka edhe shumë mangësi e probleme, sidomos linjat e munguara të avionëve në mes të Kosovës dhe Serbisë, mungesa e autostradës, apo radhët e gjata nëpër kalime.

Më 2014, marrëveshja ndërret Kosovës dhe Serbisë të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, sollti një grup zyrtarësh të Kosovës të shërbejnë në një zyrë ndërlidhëse në Beograd. Të kufizuar në hapësirë, ata patën jetuar për muaj në hotel. Kjo zyrë tashmë është funksionale.

Edhe Serbia ka një zyrë ndërlidhëse funksionale në Kosovë. Sot, një shtetas i Kosovës në rast nevojë mund të marrë asistencë zyrtare nga zyra ndërlidhëse në Beograd. E duket se suksesin e marrëveshjes e konfir-

mojnë edhe të dhënat zyrtare: vetëm paqë mungë pa fillimit të implementimit të marrëveshjes, numri i personave që kanë kaluar nga Kosova në Serbi dhe anasjelltas është rritur dukshëm. Disa mjedisë që operojnë jashtë sistemit udhëtonin rregullisht nga Kosova në Serbi dhe anasjelltas. Tish ekzistojnë gjithë linja të rregullta autobus që qarkullojnë në mes të Prishtinës dhe Beogradit.

Në të kaluarën, siç edhe kishte ndodhur, shqiptarët nga Kosova nuk kishin mundësi të u rrinin në Serbi as për më rast të shpëtojë së donjë familjar, përveç në organizim të milionëve ndërkom-bëtarë. Ishte vitet 2008, më kujtohet, kur si gazetar më duhej të kaloja për patrullat ushtarake dhe policore në lumenj Tisa. Dihetesh shqiptarët të Kosovës u patën mirëtur ur në udhë përvarat të kalonin në zontë e BE-së. Kufomat u gënden dhe u dërguan në morg. Familjarë të tyre nga Kosova më telefononin për t'i ndihmuar në marrjen e kufomave. Por unë nuk mund t'ju ndihmoja. Ata duhej të ishin fizikisht prezentë aty. Disa kufoma mbetën në morgun e Novisadit për një kohë të gjatë.

Dialogu i ndërmjetësuar nga BE-ja në mes të Kosovës dhe Serbisë ka krijuar ura, dhe paVaresisht ankesave dhe neqcejeve, ky proces sollti mjaft përfitime për qytetarët. Qarkullimi i njohësve dhe performancat komunikimi është i domosdoshëm për të krijuar një ndërlidhëse ligjore për të gjithë. Komunikimi shton tolerancën dhe njohjen, dhe krijon nd-

jesinë e normalitetit. Kjo është pjesë e rëndësishme për demokratizim dhe përballje me të kaluarën. Njerëzit lëvizin në çdo lloj kushtesh dhe rrethanash, e komunikimi këto tërë vetëm sa i përmirëson këto kushte, duke ruajtur dhe kultivuar kështu të drejtën e lëvizjes.

Sot, mijëra qytetarë dhe mërgimtarë kosovarë kalojnë nëpër Serbi me dokumente të Kosovës. Nëpër shtete të Beogradit çdo ditë takon shqiptarë nga Kosova. Ata vijnë me autobusë nga pjesë të ndryshme të Kosovës. Telefonat punojnë, edhe pse me vështirësi, por gjithësi mund të komunikohet. Kosovarët mund të qëndrojnë dhe të shërbejnë në hotele me dokumentet e tyre, si kushdo tjetër që e viziton Beogradin. Ideja e marrëveshjeve (fundja edhe është krijuar i mundësisë për lëvizje, edhe kur nuk merr pjesë në seminar.

Idro Seferi është gazetar i lirë. Me gazetarit marrë që nga viti 2003, kurse në vitin 2007 është shpërngulur nga Prishtina për në Beograd.

Ky publikim është botuar me asistencë financiare të Ambasadës së Mbretërisë Norvegjeze në Kosovë dhe Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjigjësia e vetme e Grupit për Politika dhe Avokim Kosovë-Serbi dhe në asnjë mënyrë nuk mund t'i paraqesë përpamit e Ambasadës së Mbretërisë Norvegjeze në Kosovë dhe Bashkimit Evropian.

KOHA DITORE

E përditshme e pavarur informative

Themeluar: Veton SURROJ
Humri i parë u botua më 31 mars 1997

Pronare dhe botuese:
Fika SURROJ

Gazeta redktohet nga kolegji:
Kryeredaktor: Agron BAJRAMI
Zv. kryeredaktor: Valbona MEHMETI
Redaktor: Brikanda REKHEPI
Redaktor: Elmas ISUFI

Zenun ÇELAJ (Portali),
Bekim KUPINA (Kosovë),
Visar LLOI (Sport),
Granit KURTI (Kulturë)
Nita LLESHI & Arbana MJEKICI (Botë),
Sani KÇIZI (Më për Më),
Ben KAJTAZI (Dëna Grafika),
Alban BUJARI & Otrion PAÇARADA
(Fotografi)

Adresa:
KOHA

Aneksi i Ish-Radio Prishtinës (katë i parë)
Xhorx Bush p.n.
10000 Prishtinë

Fahu postar 202

Telefonat:
(00 383 38) 249-104 249-105;
249-108; 248 014 dhe 248 015

e-mail:
redaksia@kohaditore.com,
ljajmet@kohavision.net, info@koha.net